




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Gjemajli Bellanica;	24.01.2023	01.02.2023	42/23

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 16.01.2023 OE “**ROJET E NDERIT**” Sh.p.k Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr. **42/23** kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit për anulimin e aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetit e prokurimit me titull: “**Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës**”, me nr. të prokurimit: **616-19-3238-2-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK –Prishtinë**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar kontratë publike kornizë me një operator ekonomik, procedurë të hapur, Shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 2 100.000.00 €

Data e njoftimit për kontratë.....	20.05.2019.
Sqarimet e Dosjes së Tenderit.....	03.06.2019.
Hapja e ofertave.....	13.06.2019.
Data e njoftimit të vendimit të AK-së.....	06.01.2023.
Data e kërkesës për rishqyrtim.....	10.01.2023.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesës për rishqyrtim.....	13.01.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË: OE “ROJET E NDERIT”

Sh.p.k Prishtinë

Dispozitat e shkelura

Neni 1 - Qëllimi
 Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
 Neni 27 – Dosja e Tenderit
 Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
 Neni 60 – Kriteret për dhënien e kontratës

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Panel i nderuar është e disata herë që neve nisim ankesë për të njëjtin AP ku duke u -bazuar në LPP-në dhe qdo herë ka qenë dhe është e mirë bazuar dhe qdo herë bazuar në faktet dhe argumentet që i kemi mirëbazuar konform DT-së, Sqarimeve të AK-së ankesat tona janë cilësuar të BAZUARA.

Por pa dashur të paragjykojm por veprimet, vendimet e AK-së përveq se janë ta pabazuar në LPP-ë janë në kundërtësi me vendimet e më parëshme të vetë AK-së sqarimeve të ofruara nga vetë AK, forma e shkeljeve ligjore dhe përdorimi i Standartëve të dyfishta për ne është diskriminuese dhe zbehë tek ne besimin për trajtim të drejtë dhe të barabartë.

Andaj kërkojm që Ankesa të mirëtrajtohet pasi që jemi duke u diskriminuar në masë të madhe.

Pasi që AK ka bërë një “RIVLERSIM” ku në raportin e vlerësimit të siguruar nga ne shihet qartë se nuk ka pasur ri-vlerësim konform DT-së dhe sqarimeve por vetëm fshehje të gjendjes reale.

Edhe pas kërkesë tonë për ri-shqyrtim AK nuk ka bërë shqyrtimin e tyre por vetëm se ka refuzuar atë pa duke mos marrë për bazë argumentet tona të cilat jemi të detyruar t'i rishkruajm:

Të nderuar

Bazuar në të drejtën tonë konform LPP-së edhe kësaj radhe jemi të detyruar që të shfrytëzojm të drejtën tonë për Ankesë ndaj veprimeve tuaja ndaj neshë duke mos dashur të

paragjykojm por shihen qartë se janë Tendencioze dhe Diskriminuese, dhe kanë ikur aq largë saqë me veprimet tuaja ose të personave përgjegjës tashmë është konsumuar vepra penale.

Këto i themi për arsye sepse me vendimin e fundit juve përveq se keni rënë në kundërshtim me vendimet tuaja të më herëshme keni bërë edhe mos respektim të vendimeve të OSHP-së.

Në vendimin tuajin të fundit ju nuk keni vlerësuar konform LPP-së dhe kronologjis të këtij Aktiviteti duke lënë anash disa vendime tuaja dhe të OSHP-së, ku si arsye kryesore keni cekur:

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Komuna e Prishtinës bazuar në vendimin e PSH të OSHP-së nr. 359/22 bëri rivlerësimin e ofertave për Sigurimin objekteve të Komunes së Prishtinës me nr. Të prokurimit: 616-19-3238-2-1-1 dhe numër të brendshëm 616 19 030 211.

AK – Komisioni për rivlerësimin e ofertave gjatë egzaminimit të ofertave konstatoi se të gjithë OE që kanë ofertuar kanë tejkaluar vlerën e parashikuar për këtë projekt. Vlera e parashikuar e këtij projekti ka qenë 2.100.000,00 euro, ndërsa vlera e OE që kanë ofertuar është si në tabelën më lartë.

Po ashtu komisioni i rivlerësimit të ofertave konstatoi se ky projekt është iniciuar në vitin 2019 dhe komisioni për rivlerësimin e ofertave nuk mund të japë ndonjë rekomandim për faktin që egzistojnë gjashtë vendime sikur nga AK ashtu edhe nga Paneli Shqyrtues të OSHP-së.

Data: 06.01.2023

Departamenti i Prokurimit

Pas njëfotimit për kontratë për këtë aktivitet me datë: 03.06.2019 keni ofruar sqarime lidhur me tejkalimin e buxhetit ku pyetja ka qenë "CITOJ"

5. Sipas kërkesave në DT-Aneksi .PERSHKRIMI I CMIMEVE :kërkesa për sigurimin e të gjitha objekteve (Pozitave) arrin fondin oreve I'423'008 në total për periudhën 36 mujore dhe kërkesa e juaj në DT është që Paga bruto mujore për një punëtor nga Ofruesi i shërbimeve kërkohet të jetë së paku 250 € për një muaj dhe Ofruesi i Shërbimeve gjatë realizimit të kontratës do të respektoj Ligjin e Punës në fuqi si dhe Ligjin për Shërbime Private të Sigurisë 04/L-004, të Republikës së Kosovës.

Departamenti i kontabilitetit në kompaninë tonë, ka analizuar dhe ka bërë llogaritjen sipas kërkesës për pagën 250.00 euro (muaj) për një punëtor, atëherë është vërejtur dhe vërtetuar se Vlera e parashikuar për këtë kontratë sipas FDT prej 2'100'000.00 euro nuk e mbulon koston reale për pagat e punëtorëve dhe shpenzimeve tjera operative sipas kërkesës së DT - .Meqëse sipas llogaritjeve tona vlera e ofertave të OE do të tejkaloj dukshëm buxhetin e parashikuar të Autoritetit të juaj, gati dikund 3'000'000.00€

Pyetja jonë është: Se si do të veprohet me tutje apo do të anulohet i terë procesi i tenderimit?

PËRGJIGJËJA JUAJ

5.Lidhur me pyetjen tuaj referohuni dosjes se tenderit, saktësisht Aneksit 1 tek specifikimet teknike që do të thote se Kontarta Kornize mund të shtohet dhe për 30% që arrijnë vlerën 2.730.000,00.

PËRGJIGJËJA JUAJ

5.Lidhur me pyetjen tuaj referohuni dosjes se tenderit, saktësisht Aneksit 1 tek specifikimet teknike që do të thote se Kontarta Kornize mund të shtohet dhe për 30% që arrijnë vlerën 2.730.000,00.

Kur të arrihet kjo vlerë sipas dispozitave ligjore Kontrata Kornize duhet të ndërpritet.

Provë: SQARIMI JUAJ DATË 03.06.2019 (i dorëzuar në sistem të Eprokurimit).

Pra "ARSYETIMI" se të gjithë OE-të kanë tejkaluar buxhetin nuk qëndronë pasi që sqarimet tuaja para hapjes së ofertave kanë lënë një mundësi të tillë dhe kemi vepruar konform sqarimeve tuaja.

Sapër KORREKTËSI ju si AK keni plotë raste që keni nënshkruar kontrata me tejkalime buxhetore :

Si raste konkrete:

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES	616-22- 9970-1-1- 1	Furnizimi dhe montimi i gjeneratorëve për institucionet edukativo-arimore dhe nevojat tjera komunale	Procedurë e hapur, Vlerë e madhe	300,000.00
---------------------------------------	---------------------------	--	--	------------

Për këtë projekt ju keni paraparë buxhet prej 300 mijë euro dhe keni nënshkruar në vlerë prej 349,890.00 që i bie afër 50 mijë euro mbi buxhet.

AKTIVITETI TJETËR

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES	616-20- 1939-2-1-1	Pastrimi dhe mirmbajtja e objekteve ne QKMF dhe QMU	Procedurë e hapur, Vlerë e madhe	850,000.00
------------------------------------	-----------------------	--	-------------------------------------	------------

Vlera e përgjithshme e kontratës 1 042 662,24 EUR pra edhe këtu ka tejkalim bugjeti për më shumë se 200 mijë.

Pra bazë ose mungesë praktikash për nënshkrim të kontratës me OE që kanë tejkaluar bugjetin nuk keni pasi që keni plotë raste ku keni nënshkuar.

Sa i përket tabelës së OE-ve pjesëmarrëse në këtë AP ne do i rendisim të gjitha Arsyetimet për secilin veq e veq ku janë të eliminuar dhe nuk kanë treguar interes për këtë AP që nga vendimet tuaja:

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Shpirt Neni 43.7 dhe 44.2 të Rregullores dhe Udhëzimit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës"

Numri i aktivitetit të prokurimit: 616-19-3238-2-1-1 dhe numër të brendshëm 616 19 030 211


Radhë	Lënda / grupi: Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës	Qmimi total i ofertës (me TVSH)	Vlera e parashikuar e ofertës	Tejkallimi i vlerës së parashikuar për:
1.	Rojet e nderit Shpk, Prishtinë 10000 Prishtinë	3.107.462,40	2.100.000,00	1.007.462,40
2.	Grupi i Operatoreve Ekonomik Internat Security Association Shpk; Nazeri 2000 Shpk Dega ne Kosove, Mustafe Kruja nr 3, 10000 Prishtinë	2.379.456,00	2.100.000,00	279.456,00
3.	Grupi i Operatoreve Ekonomik Commando Shpk; Group for security Shpk; Autona-Pol-1 Shpk, Rt. 11 marsi Lam, 2/2 20000 Prizren	2.729.376,00	2.100.000,00	629.376,00
4.	Security Code Shpk, Muharrem Fejza – BLL, III Hy, IV Lokalit. 15-1, 10000 Prishtinë	2.676.585,00	2.100.000,00	576.585,00
5.	K.S. Besa Security Shpk, Rruga Jusuf Gervalla , nr. 64, 10000 PRISTINE	2.561.414,40	2.100.000,00	461.414,40

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Sa i përket Grupit të OE-ve INTERNATIONAL SECURITY ASSOCIATION & NAZERI 2000-DEGA KOSOVË,

Është eliminuar nga gara nga ana juaj për këtë arsye:

Nr. i prokurimit	616-19-3238-2-1-1
Sq. i kërkesës	616-19-030-211



Letër standarde për tenderuesin e eliminuar *

KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, TRUPQES NR.2 - PRISHTINE
 Per Grupin e OE-ik ISA SHPKëNazeri 2000 SHPK Dega ne Korova 03 09 2020

Titulli „Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës“
 Te ndëruar

Faleminderit që mendt pjesë në procedurën e hartohesave të prokurimit publik. Procedura është udhëzuar në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 041-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 041-237, ligjin Nr. 051-068 dhe ligjin Nr. 051-092, siç citohet në vazhdim “LPP”.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në datën e tenderit. Në kushtet që ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve të vijim:

Tenderi i juaj është administruar i ndaluar e papërgjegjshme:

- ☐ Nuk i kemi përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit;
- ☐ Nuk i kemi plotësuar dhe nënshkruar si detyrë ~~kontraktin~~ ~~kontraktin~~;
- ☐ Nuk i kemi plotësuar Specifikimin Teknik të dhënë në Aneksin I;
- ☐ Nuk i kemi përmbushur kërkesat e vlerësimit të tenderit;
- ☐ Nuk i kemi përmbushur kushtet e njohjes së kopjeve të kërkesave;
- ☐ Nuk e kemi parashituar deklarimin e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant të prokurimit;
- ☐ Grahmbajtja aritmetike e evidencuarja është me shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës;
- ☐ Në Ofertën juaj financiare nuk është në përputhje me kërkesat e Ligjit të punës .
- ☐ Nuk i kemi përmbushur kërkesat e PRASHKËSHIT.

Tenderi juaj është refuzuar për këto ARSYE:


Bazuar në faktin se drejtuesi i anetarit të grupit tuaj “Nazeri 2000”, Mehmet Bazarj është denuar për shpërdorim detyre në vitin 2019 dhe se denimi është shqiptuar pas publikimit të Njoftimit për kontratë (Njoftimi është publikuar me datën 13.06.2019, ndërsa denimi është i datës 14.07.2019) dhe në formulimin ligjor të nenit Bazarj 65.5 ku thëkët si vijon: “Përlidhat kohë të përcaktuara në këtë nen ndërlidhen me periudhën që menjëherë paraprin e datën e publikimit të njoftimit të

kontrates ose, në rast të procedurave të negociuara pa publikim të njoftimit të kontrates, dërgimin e ftesës për pjesëmarrje ose tenderim.” në fillim është menduar se kjo nuk mund të jetë pengesë për trajtimin e tenderit tuaj si i pranueshem, mirëpo duke analizuar komplet nenin 65 kemi hasur në pa qartësi e sidomos me formulimin e pikës 65.3 ku shkruan si vijon: “Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara;

Pra ky grup i OE-ve nuk ka përmbushur kërkesat e pranueshmerisë e dëshmuar nga vetë ata dhe përmes interpretimit të KRPP-së.

Provë Letra Standarte e datës 01.03.2021.

Sa i përket GOE COMMANDO shpk, GFS & AULONA POL



Letër standarte për tenderuesin e eliminuar¹

KOMUNITETI KOMUNES SE PRISHTINES, TIRFQES NR.2 - PRISHTINE

Cyphilerëve Dhomave - Security Code

Nr. i prokurimit	616-19-3238-2-1-1
Nr. i tenderit	616-19-030-211

Titulli: "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës"

Letër standarte për tenderuesin

Te referuar

Kalorimderit që morët pjesë në procedurën e hartimit të prokurimit publik. Procedura është udhëzuar në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik, Nr. 041-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 041-232, ligjin Nr. 051-068 dhe ligjin Nr. 051-092, siç shihet në varëdimin "1 PP".

Tenderi juaj është shqyrtuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontraktit dhe në *letërin e tenderit*. Me leqandhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Tenderi juaj është administruar dhe përpunuar si:

- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë në tenderit;
- ☐ Nuk i keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet *(Formularin e parashtrës në tenderit)*;
- ☐ Nuk i keni plotësuar Specifikimin Teknik të dhënë me Ankesën 1;
- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e afatshumërisë së tenderit;
- ☐ Nuk e keni parashtruar miratimin e informueshëm të kopjeve të kërkuara;
- ☐ Nuk e keni parashtruar deklarimin e cilës identifikues në kontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant të prokurimit;
- ☐ (Gjithmëherë) arsimet dhe tërësit e shprehura në shprehje të dy përfaqësojnë (2%) të shprehjeve totale të ofertës;
- ☐ Në oferta e juaj, në përputhje me nenin 6.1.4 dhe Konsideruar si oferte abnormale dhe ulët;
- ☐ Nëse oferta e shprehur, kërkesat për formidat informueshëm;
- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e **PËRSHENJESHMERIS E APËRIVE PROJEKSIONIT**.

ARSYETIMI

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

- Ju jeni eliminuar për këtë aktivitet sepse nuk keni dërguar sqarimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues lidhur me çështjen juve referuarit të mëtej.

¹ Ky letër e shprehjet informueshëm kushtet që jeni eliminuar. Tenderi e kësaj lloji (siç shihet nga përkufizimi i kushtetimit) nuk mund të jetë përgjigjeve dhe të përdoret.

- ☐ Nëse bëni të Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur 1 PP apo rregullat e shprehura. Ju keni të drejtë të paraqitni ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 103/A të Ligjit Nr. 041-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 041-232, ligjin Nr. 051-068 dhe ligjin Nr. 051-092.

Edhe nëse nuk keni qenë në gjendje t'i përkrahni shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesin për nënshkrimin të ardhshëm të prokurimit.

Këtë OE e keni eliminuar pasi që nuk është përgjigjur në kërkesën për sqarim.

Provë Letra Standarte e datës 09.10.2019.

Sa i përket OE BESA SECURITY ju me datë 20.01.2020 e keni eliminuar për arsye konform venidmit të OSHP-së

Letër standarde për tenderuesin e eliminuar¹

KUVENDI KOMUNES SE PRISHTINES, TREFQEN NR.1 - PRISHTINE
Per Grupin e OE-je Beta Security-Prishtine

Titulli: „Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës“

Error! Bookmark not defined.

Te nderuar

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e hartshënues të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në varhdin “LPP”.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontraktit dhe në *durojen e tenderit*. Me këqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Tenderi i juaj është administrativisht e përgjigjshëm:

- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit;
- ☐ Nuk i keni plotësuar dhe ngathtësuar si duhet *[shprehje e paqartë]*
- ☐ Nuk i keni plotësuar Specifikimin Teknik të dhënë në Aneksin I
- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;
- ☐ Nuk e keni paraqitur numrin e inkuizueshëm të kopjeve të kërkuara;
- ☐ Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant të prokurimit;
- ☐ Gëhim(et) aritmetikor i evlësuar(et) është më shumë se dy përqind (2%) i vlerës totale të ofertës;
- ☐ X Oferta e juaj, në përputhje me nenin 61.1 të kësaj Kontraktuar si oferte abnormalisht e ulët;
- ☐ Nëse gabim e shprehshme, kërkesa tjera formale administrative;
- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e PËRSHTATSIMËRIN E AFTËSIVE PROFESIONALE.

ARSYETIMI

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :

Është Konstatuar se çmimi i dhënë për orë punë në tenderin tuaj prej 1,83 € nuk plotëson kërkesat për mbledhjen e pages së kalkuluar.

¹ Kjo letër e shprehshme procedurës konkurruese që janë eliminuar. Tenderi e të cilëve janë refuzuar nga përmirësimi e korrigjimit nga kjo letër që në të përgjigjshëm dhe të përcaktuar.

Bazuar në Vendimin e OSHP-es dhe Dispozitave Ligjore është konstatuar se si kritere të matshme për kalkulim të pages bruto mund të merren vetëm pushimet vjetore dhe ditët e festive . Duke përfshirë këto kritere është konstatuar se çmimi minimal për orë punë është 1,91 €, ky është çmimi më i ulët që mundëson pagesën e pages bruto sipas Vendimit të OSHP-es dhe Interpretimit të ATK-es.

- ☐ Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të paraqitoni ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Provë letra standarte e AK-së datës 20.01.2020.

Përveq kësaj ky OE është cilësuar si palë pa interesë nga ana juaj konform vendimit tuaj të datës 15.03.2021 për arsye se nuk i'u është përgjigjur kërkesave tuaja.

Provë vendimi i datës 15.03.2021

Po ashtu ky OE kishte kërkuar që të anulohet ky AP dhe në atë kohë juve keni cekur se

-Pretendimi juaj se sqarimet tona e kanë kushtëzuar çmimin e tenderit tuaj poashtu është i pa qendrueshëm, pasi që ju keni cekur vetëm një pjesë të tekstit: "Lidhur me pyetjen tuaj referojuni dosjes së tenderit, saktësisht Aneksit 1 tek specifikimet teknike që do të thotë se kontrata kornize mund të shtohet për 30% që arrijn vlerën prej 2.730,000.00 €", ndërsa nuk e keni përfshirë pjesën tjetër të përgjigjes që sqaron se kemi të bëjmë me kontratë kornize dhe e njëjta mund të ndërprehet në momentin që arrijn vlerën e parashikuar, e cila pjesë tregon qartë se nuk ka pasë asnjë kufizim për çmimin tuaj as të tenderuesëve tjerë. Poashtu ne sqarimet tona është cekur se tenderuesit duhet t'i përfshijnë në çmimet e tyre të gjitha detyrimet ligjore dhe ata që nuk i përfshijnë të njëjtat do të trajtohen si të pa përgjegjshëm.

-Poashtu ju sqaroj se lidhur me tenderuesin e propozuar ne asnjë rast as Autoriteti Kontraktues e as OSHP-ja nuk e kanë trajtuar tenderuesin "Rojet e Nderit" si të pa përgjegjshëm, por vetëm është konstatuar se çmimi i tij është mbi vlerën e parashikuar;

Bazuar në konstatimet paraprake konstatohet se pretendimet tuaja janë të pa bazuara dhe kërkesa juaj refuzohet.

Provë vendimi i datës 19.05.2021

Pra shihet qartë se vlerësimet e më parëshme kanë qenë dhe janë konform LPP-së dhe se privimi nga e drejta e nënshkrimit të kontratës është veq se një konsumim i veprës penale pasi që është mos respektim i LPP-së dhe mos zbatim i vendimeve të OSHP-së dhe tuajat në të njetën kohë.

Me datë 10.01.2023 kemi pasur qasje në raportin e vlerësimit të cili na është dhënë jo i plotë përveq kësaj ky Raport është i papranueshëm për ne madje mendojmë se është i ndikuar pasi që asnjë nga faktet e sipër shënuara nga ana jonë nuk janë të pasqyruara, fakëte që nuk i kemi shpikur ne por janë publikuar përmes formave standarte dhe zyrtare konform LPP-së. Raporti i fundit i "Rivlerësimit" nuk përbën ndonjë vlerësim por vetëm kamuflim i situatës për arsye të pa qarta për ne.

Të nderuar

Duke u bazuar në LPP kërkojmë që të APROVONI ANKESENË tonë dhe AP ta detyroni AK ta rivlerësoj drejtë dhe konform LPP-së DT-së dhe sqarimeve tuaja duke rishpallur ofertën tonë si më të lirën të përgjegjshme.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

Kërkesa 1. OE duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se ka qarkullim financiar në tre vitet e fundit (2016, 2017 dhe 2018) në vlerën minimale prej 3,000,000.00 €

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, në vlerë minimale prej 3,000,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë).

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme,) ne vlerë minimale prej 3,000,000.00 Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë).

Kërkesa 2. OE DUHET TE DEKLAROHET SE PUNETOREVE DO TUA PAGUAJ PAGEN MINIMALE BRUTO 250€

Kërkesa3. OE duhet të angazhoj personelin profesional të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollare të mëposhtme a) një (1) Menaxher të projektit i cili duhet të ketë përfunduar me sukses trajnimin e specializuar për menaxher të sigurimit zyrtar në detyrë dhe të posedojë licencën valide të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme b) dy (2) ndihmesa për projekt menaxherin të cilët duhet të ketë përfunduar me sukses trajnimin e specializuar për menaxher të sigurimit zyrtar në detyrë dhe të posedojë licencën valide të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme

Kërkesa 4. OE duhet të ketë të gjitha pajisjet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të sigurimit themelor, si Breza, Shufra, Pranga, Bateri ndriçuese, Radio Lidhje mobile dhe fikse etj

Kërkesa 5. Operatori Ekonomik duhet të posedoj ose të marr me qira se paku 8 (tete) Automjete patrulluese

Kërkesa 6. OE duhet të posedoj minimum 8 (tete) Operator të Sigurisë të licencuar për monitorimin e sistemeve të sigurisë (Operator nënkupton stafi i angazhar nga operatori ekonomik, i cili staf është i licencuar për monitorimin dhe vëzhgimin e sistemeve të sigurisë), dhe 2 Menaxher për OME.

Kërkesa 7. OE duhet të ketë Marrëveshje me një Qendër Trajnimi të licencuar për kryerjen e trajnimeve të rojeve të sigurimit në fushën themelore dhe të specializuar sipas Ligjit Nr.04 L-004, për Shërbimet Private të Sigurisë.

Dëshmitë e kërkuara dokumentare të përshtatshmërisë profesionale

1. Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuar nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur

Dëshmitë e kërkuara dokumentare mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

1. Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuar nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur

Dëshmitë e kërkuara mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të

bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve. a) Kur shërbimi është bërë për një autoritet publik në Kosovës ose në një vend tjetër, për dëshmi duhet të dorëzohen certifikata e pranimi ose referenca të lëshuara nga autoriteti i tillë. b) Kur shërbimi është bërë për një blerës privat, duhet të dorëzohet certifikata e pranimi ose referenca të lëshuara nga blerësi i tillë.

2. DEKLARATA E NENSHKUAR DHE E VULOSUR NGA OE

3. a) Për Menaxherin e Projektit Kopja e diplomës universitare, CV, referenca pune dhe kopja e licencës për trajnimin e specializuar, b) Për ndihmesat Kopja e diplomës së shkollës së mesme, CV, referenca pune, dhe kopja e licencës për trajnimin e specializuar

4. DEKLARATA E NENSHKUAR DHE E VULOSUR NGA OE

5. Kopjet e librezave të regjistrimit të Automjeteve (me validitet regjistrim. Në rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet të dorëzojë edhe marrëveshjen për shfrytëzim.

6. Lista e stafit dhe licencat valide për operatorët dhe menaxherët për OME

7. Kopja e marrëveshjes dhe kopja e licenses së qendrës së trajnimit për shërbimet themelore dhe të specializuara (valide)

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzimit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës"

Numri i aktivitetit të prokurimit: 616-19-3238-2-1-1 dhe numër të brendshëm 616 19 030 211

Radhë	Lënda / grupi: Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës	Çmimi total i ofertës (me TVSH)	Vlera e parashikuar e ofertës	Tejkalimi i vlerës së parashikuar për:
1.	Rojet e nderit Shpk, Prishtinë 10000 Prishtinë	3.107.462,40	2.100.000,00	1.007.462,40
2.	Grupi i Operatoreve Ekonomik Internat Security Association Shpk; Nazeri 2000 Shpk Dega në Kosovë. Mustafe Kruja nr 3.10000 Prishtinë	2.379.456,00	2.100.000,00	279.456,00
3.	Grupi i Operatoreve Ekonomik Commando Shpk; Group for security Shpk; Aulona-Pol-1 Shpk. Rr. 11 marsi Lam.2/2 20000 Prizren	2.729.376,00	2.100.000,00	629.376,00
4.	Security Code Shpk, Muharrem Fejza – B.L.L. III.Hy.IV.Lokali.15-1, 10000 Prishtinë	2.676.585,00	2.100.000,00	576.585,00
5.	K.S. Besa Security Shpk, Rruga Jusuf Gervalla . nr. 64, 10000 PRISTINË	2.561.414,40	2.100.000,00	461.414,40

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Komuna e Prishtinës bazuar në vendimin e PSH të OSHP-se nr. 359/22 heri në rivlerësimin e ofertave për Sigurimin objekteve të Komunës së Prishtinës me nr. Te prokurimit: 616-19-3238-2-1-1 dhe numër të brendshëm 616 19 030 211.

AK – Komisioni për rivlerësimin e ofertave gjatë egzaminimit të ofertave konstatoi se të gjithë OE që kanë ofertuar kanë tejkaluar vlerën e parashikuar për këtë projekt. Vlera e parashikuar e këtij projekti ka qenë 2.100.000,00 euro, ndërsa vlera e OE që kanë ofertuar është si në tabelën më lartë.

Po ashtu komisioni i rivlerësimit të ofertave konstatoi se ky projekt është iniciuar në vitin 2019 dhe komisioni për rivlerësimin e ofertave nuk mund të japë ndonjë rekomandim për faktin që egzistojnë gjashtë vendime sikur nga AK ashtu edhe nga Panelet Shqyrtuese të OSHP-se.

Data: 06.01.2023
Departamenti i Prokurimit

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi Nr.735,744,757/19; Vendimi Nr.82,83,92/20; Vendimi Nr.332/20; Urdhëresë nr.563/20; Vendimi Nr.896,912/20, Vendimi Nr.230,267/22; Vendimi 359/22

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE “ROJET E NDERIT” Sh.p.k Prishtinë

Sqarim hyrës:

Eksperti shqyrtues, paraqet kronologji lidhur me rrjedhën e këtij aktiviteti të prokurimit i cili është në procedurë nga viti 2019 deri me tani dhe ende nuk ka marrë ndonjë epilog përfundimtar pasi që deri më tani janë 6 vendime të Paneleve Shqyrtuese dhe një urdhëresë për zbatim të vendimeve të OSHP-së.

Pas hapjes publike të ofertave AK-Komuna e Prishtinës sipas vlerësimit përfundimtarë rezultoi se për kontratë rekomandohet OE “Security Association SH.P.K.; NAZERI 200 SH.P.K DEGA NË KOSOVË” me çmim prej 2 379 456.00 Euro dhe me përjashtim të OE “COMMANDO SH.P.K; Group For Security SH.P.K; “AULONA-POL-I” SH.P.K, i cili konsiderohet i papërgjegjshëm të gjithë OE tjerë konkurrent trajtohen të pasuksesshëm.

Lidhur me këtë Vendim të AK-së, parashtrohen kërkesë për rishqyrtim nga OE “Comando” dhe OE “Rojet e nderit”, dhe kërkesat për rishqyrtim aprovohen si pjesërisht të bazuara dhe AK përsëri rivlerëson Aktivitetin e Prokurimit dhe me datën 10.10.2019, AK del me vendim të ri dhe për kontratë rekomandon OE “Comando” ndërsa OE “Rojet e nderit” e trajton të pasuksesshëm ndërsa OE tjerë i eliminon nga konkurrenca.

Gjithashtu edhe në këtë vendim parashtrohen kërkesa për rishqyrtim dhe AK përsëri me datë 21.01.2020 nxjerr vendim dhe për kontratë rekomandon OE “Comando”, por këtij vendimi të AK-së të datës 21.01.2020 i paraprin vendimi i Panelit Shqyrtues i datës 07.11.2019, nr.735,744,757/19, ku ishte kërkuar që procesi i tenderimit të rivlerësohet por pas rivlerësimit OE “Comando”, kishte rezultuar i rekomanduar.

Po ashtu vendimi i dt.21.01.2020 ku fitues ishte OE “Comando”, Paneli Shqyrtues në bazë të akteve të pranuar me nr.82,83,92/20 me dt.11.03.2020 kishte lëshuar vendim ku kërkon rivlerësimin e ofertave dhe me dt.13.05.2020 AK nxjerr vendim ku për kontratë rekomandon OE “Rojet e nderit”

Për këtë vendim të Autoritetit Kontraktues, Paneli Shqyrtues i OSHP-së me datë 26.06.2020 nxjerr vendimin nr.332/20 ku përsëri kërkon rivlerësimin e Aktivitetit të Prokurimit.

Për mos zbatim të vendimeve të OSHP-së me datë 04.10.2020, Paneli Shqyrtues lëshon urdhëresë me nr.563/20, ku kërkon zbatimin e vendimeve të cekura më lartë.

Për këtë Aktivitet të Prokurimit, Paneli Shqyrtues me dt. 04.12.2020 lëshon përsëri vendim sipas ankesave me nr.896/20 dhe 912/20 dhe kërkon që AK të rivlerësoj Aktivitetin e Prokurimit ku tani fitues ishte OE “Rojet e Nderit”.

Autoriteti Kontraktues me vendim të datës 01.03.2021 për kontratë rekomandon OE Rojet e Nderit”, ndërsa OE “Besa” dhe “Internat Security Association SH.P.K; NAZERI 2000” dhe të pa kënaqur me kërkesën për rishqyrtim të dy OE me datë 12 dhe 15 Mars 2021 parashtrojnë ankesë në OSHP dhe për shkak të mungesës së Bordit të OSHP-së deri me datë 29.07.2022 OSHP nuk kishte lëshuar vendim lidhur me këtë Aktivitet të Prokurimit.

Në vendimin e datës 21.07.2022 nr.230 dhe 267/21, Paneli Shqyrtues i OSHP-së i hedh ankesat jashtë afatit për shqyrtim dhe si rezultat i kësaj AK anulon aktivitetin e prokurimit.

Gjithashtu, Paneli Shqyrtues në vendimin nr.359/22 i datës 27.10.2022, ka konstatuar si në vijim:

Bazuar në pretendimet e parashtruara dhe arsyetimin lidhur me anulim, të dhënë nga AK, PSH konstaton se nuk plotësohet asnjë nga kushtet për anulim të tenderit sipas nenit 62 të LPP-së, ashtu që ankesa e OE ankuese konsiderohet si e bazuar dhe obligohet AK të anuloj vendimin mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në rivlerësim tek AK.

Me dt.06.01.2023, AK-ka nxjerre njoftim mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit si në vijim:

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Komuna e Prishtinës bazuar ne vendimin e PSH te OSHP-se nr. 359/22 beri rivleresimin e ofertave per Sigurimin objekteve te Komunes se Prishtines me nr. Te prokurimit: 616-19-3238-2-1-1 dhe numër të brendshëm 616 19 030 211.

AK – Komisioni per rivleresimin e ofertave gjate egzaminimit te ofertave konstatoi se te gjithë OE qe kane ofertuar kane tejkaluar vleren e parashikuar per kete projekt. Vlera e parashikuar e ketij projekti ka qen 2.100.000,00 euro , ndersa vlera e OE qe kane ofertuar eshte si ne tabelen me larte.

Po ashtu komisioni i rivleresimit te ofertave konstatoi se ky projekt eshte iniciuar ne vitin 2019 dhe komisioni per rivleresimin e ofertave nuk mund te jape ndonje rekomandim per faktin qe egzistojne gjashte vendime sikur nga AK ashtu edhe nga Panelet Shqyrtuese te OSHP-se.

Data: 06.01/2023

Departamenti i Prokurimit

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke pasur parasysh ecurinë e aktivitetit te prokurimit, Eksperti Shqyrtues lidhur me ankesën e parashtruar me nr.42/23, nuk mund të jap ndonjë vlerësim apo rekomandim pasi që për këtë lëndë janë 6 vendime të Paneleve Shqyrtuese dhe 6 vendime të Autoritetit Kontraktues.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues - KK -Prishtinë

Panelit Shqyrtues - OSHP

OE ankues -OE "ROJET E NDERIT" Sh.p.k Prishtinë